



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA THEMELORE PEJË
OSNOVNI SUD PEĆ – BASIC COURT PEJA

P nr. 712/16

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË PEJË D.P. , gjyqtari Sejdi Blakaj me sekretaren juridike Gjyljeta Çorkadiu , në lëndën penale kundër të pandehurit A.Th , sipas aktakuzës së PTH-së D.P. në Pejë PP/II. nr.832/16 të dt.22.8.2016, për shkak të veprës penale: lëndim i lehtë trupor nga neni 188 par 2 nën par 1.1 të KPRK-së pas përfundimit të shqyrtimit fillestar , publik dhe me gojë, të mbajtur në praninë e të pandehurit A.Th dhe të prokurorit të shtetit Muharrem Bajraktari me dt.04.10.2017 ka marrë dhe botërisht ka shpallë këtë :

A K T G J Y K I M

I pandehuri A.Th i lindur me dt.....nërruga, ku edhe tani jeton, i biri i Z dhe nënës Z e gjinisë B , Shqiptar, Shtetas i Republikës së Kosovës , më parë i pa dënuar, gjendet në liri.

ËSHTË FAJTOR

Për arsye se:

Me dt. 31.3.2016 rreth orës 22:25 minuta, në Pejë në rrugën Hilmi Malishaj , tjetrit i shkakton lëndime të lehta trupore dhe atë të dëmtuarit A. A në atë mënyrë që m pasi i dëmtuari kishte shkruar për të blerë bukë e takon vëllain e të pandehurit A , dhe gjersa po bisedonte me të afrohet i pandehuri i cili e shtynë fillimisht të dëmtuarin pastaj fillon ta grushtoj , një herë në syrin e majtë e pastaj në kokë , dhe në pjesë të ndryshme të trupit , me çka i shkakton lëndime të lehta trupore me pasoja të përkohshme në shëndet.

-me çka ka kryer veprë penale : lëndim i lehtë trupor nga neni 188 par 2 nën par 1.1 të KPRK-së

Prandaj gjykata të pandehurit konform nenit 41, 42, 49, 50,51,52, dhe nenit 188 par 2 nën par 1.1 të KPRK-së. I SHQIPTON.

DËNIM TË KUSHTËZUAR

Në atë mënyrë që ia përcakton dënimin me burg në kohëzgjatje prej 6 muaj , e të cilin dënim i pandehuri fare nuk do ta vuaj nëse në afat prej 1 viti nuk kryen ndonjë vepër tjetër penale .

Obligohet i pandehuri që në emër të paushallit gjyqësorë të paguaj shumën prej 15 euro, kurse në emër të shpenzimeve të procedurës penale shumën prej 20 euro - 15 ditë pasi që aktgjykimi të merr formën e prerë.

I dëmtuari për realizimin eventual e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontest civil.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Pejë me dt.22.8.2016 kundër të pandehurit A. Th ka ngritë aktakuzë PP/II. nr.832/16, për vepre penale : lëndim i lehtë trupor nga neni 188 par 2 nën par 1.1 të KPRK-së ,duke i propozuar gjykatës që pas përfundimit të shqyrtimit gjyqësorë të pandehurin ta shpallë fajtorë , ta dënoj sipas ligjit dhe ta obligoj në pagimin e shpenzimeve procedurale .

Në shqyrtimin fillestarë i pandehuri – pasi që paraprakisht i është lexuar aktakuza , është njoftuar me të drejtat dhe detyrimet procedurale dhe pasojat e pranimit përkatësisht të mos pranimi të fajësisë- e ka pranuar fajësinë dhe ka manifestuar keqardhje për atë që i ka ndodhur. Këtë pranim fajësie gjyqtari – pasi që paraprakisht e ka marrë pëlqimin e prokurorit të shtetit, i bindur se pranim fajësinë i pandehuri e ka bërë ashtu siç e parasheh ligji – vullnetarisht dhe pa u ndikuar nga askush dhe në asnjë mënyrë -e ka pranuar .

Meqenëse i pandehuri e pranoi fajësinë gjyqtari kaloi në marrjen e vendimit lidhur me llojin dhe lartësinë e masës ndëshkuese , me ç rast i pati parasysh të gjitha rrethanat rënduese dhe lehtësuese. Rrethanë rënduese në rastin konkret gjyqtari nuk ka gjetur , kurse nga ato lehtësuese ka çmuar : pranimin e singertë të fajësisë , pendimin e thellë për këtë gjë, qëndrimin korrekt në gjykatë, pa dënueshmërinë e mëparshme , dhe kësaj gjyqtari mendon se edhe me një vendim si në dispozitivin e aktgjykimit ndaj të pandehurit do të arrihet qëllimi i ndëshkimit i paraparë me neni 41 të KPK-së .

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale dhe të paushallit gjyqësor është marrë konform nenit 450 të KPPRK-së.

Vendimi mbi udhëzimin e të dëmtuarit në kontestin e rregullt civil është marrë konform nenit 463 të KPPRK-së .

Nga sa u tha më lartë konform nenit 365 të KPPRK-së u vendos si më lartë.

Nga Gjykata Themelore në Pejë D.P. datë. 04.10.2017.

Sekretarja juridike
Gjyljeta Çorkadiu

Gjyqtari
Sejdi Blakaj

KËSHILLA JURIDIKE

Kundër këtij aktgjykimi lejohet
Ankesa në afat prej 15 ditësh nga
Dita e marrjes , Gjykatës të Apelit në Prishtinë
E përmes kësaj Gjykate .